



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d, të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 11, paragrafët 1, 2 dhe 4 të Ligjit nr. 04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 35/17, dhjetor 2012), nenit 33.2, shkronja a, dhe nenit 34.1, shkronja d, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 31.10.2018, merr këtë

#### V E N D I M

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarit Zeqir (Mehmet) Haxhija.
- II. 1. Prona e paluajtshme e Komunës që do të jepet në këmbim, ka këto karakteristika: pjesë e parcelës kadastrale nr. 2997-1, e evidentuar në certifikatën e pronës P-71914059-02997-1, Zona Kadastrale (ZK) Prishtinë, e evidentuar si "pasuri shoqërore", Rrugë, Kuvendi Komunal Prishtinë.  
2. Prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim është pjesa e parcelës kadastrale nr. 1861-1, e evidentuar në certifikatën e pronës P-71914059-01861-1, ZK Prishtinë, në emër të pronarit Zeqir Haxhija, me destinim "rrugë e planifikuar, gjelbërim dhe hapësirë publike", sipas Planit rregullues "Kalabria".
- III. Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës të tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private.
- IV. Këmbimi i pronave të paluajtshme është bërë pasi nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për realizimin e Planit rregullues urban, kjo i shërben shfrytëzimit për qëllime të interesit publik të Komunës, dhe kapitali për financimin e këmbimit është siguruar.
- V. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të parcelave kadastrale që do të këmben.



- VI. Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbehen, të përshkruar në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastralë të Komunës.
- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VIII. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë shkresat e lëndës.
- IX. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
01-463/01-0263783/18, më 01.11.2018

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
Agim Kuleta